



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJEVE TË DISA QV-VE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 29.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4 dhe 11, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Prefekti i Qarkut Fier, me me shkresën nr 12 866 prot., daë 29.06.2019, në vlerësim të situatës aktuale, për mos vënien në dispozicion të ambienteve nga institucionet vendore, në ushtrim të përgjegjësisë bazuar në ligjin 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", si dhe të shqetësimeve të shprehura nga KZAZ nr. 61, verifikimeve të kryera në terren nga KZAZ dhe Inspektori Rajonal, ka paraqitur kërkesë për dhënien e autorizimit nga KQZ për ndryshimin e vendndodhjeve të gjashtë QV, nw Bashkinw Mallakastwr.

Prefekti i Qarkut Korçë, me me shkresën nr 12 985 prot., daë 29.06.2019, në vlerësim të situatës aktuale, për mos vënien në dispozicion të ambienteve nga institucionet vendore, në ushtrim të përgjegjësisë bazuar në ligjin 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", si dhe të shqetësimeve të shprehura nga KZAZ nr. 67, dhe KZAZ nr. 70, pas verifikimeve të kryera në terren nga KZAZ-të përkatëse, ka paraqitur kërkesë për dhënien e autorizimit nga KQZ për ndryshimin e vendndodhjeve të 17 QV në Bashkinë Pogradec dhe 3 QV në Bashkinë Devoll.



Kzaz nr.42, Bashkia Kavajë, me shkresën nr. 12632, datë 28.06.2019, duke vlerësuar faktin se ndërtesa ku janë vendosur QV nr. 2189, nr.2189/1, Institucioni "Ujësjiellës Kanalizime Kavajë" me urdhër të brendshëm ditën e diele e ka ditë pune, që që e bën të pamundur funksionimin e këtyre ambienteve si QV, kërkon ndërhyrjen kryesisht të KQZ për të dhënë autorizimin për ndryshimin e vendndodhjeve të tyre duke i caktuar në Godinën e OSHEE, me vendndodhje aty pranë.

Kzaz nr.63, Bashkia Kuçovë, me shkresën nr. 12867, datë 29.06.2019, duke vlerësuar pamundësinë e funksionimit të QV nr. 3513, pasi pronari është larguar, kërkon ndërhyrjen kryesisht të KQZ për të dhënë autorizimin për ndryshimin e vendndodhjes së kësaj QV duke e caktuar në lokal privat me sipërfaqe 150 m², me pronar Lavdosh Tavanin.

Kryetari i Bashkisë Has, me shkresën nr. 12982, datë 29.06.2019, kërkon dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 0530, për shkak të djegies nuk mund të funksionojë si Qendër Votimi.

Propozohet që QV nr. 0530, të caktohet në Shkollën 9-vjeçare Vranisht.

KQZ, në ushtrim të kompetencave përcaktuar në nenin 21, pika 3, të Kodit Zgjedhor, vlerëson situatën dhe propozimet e paraqitura, në funksion të zbatimit të rregullave dhe qetësisë së procesit zgjedhor të datës 30.06.2019.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 21, pika 3, nenin 62, pika 4 dhe 11, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor nr. 10, nr.61, nr.67, nr.70, nr. 42, nr. 63 të publikojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

